

VENDIM
Nr. 236, datë 20.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TARIFËS SË PAGESËS PËR ANKIMIN NË NJË PROCEDURË PROKURIMI PRANË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 120, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ankesa e paraqitur pranë autoritetit ose entit kontraktor, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nga çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, duhet të përmbajë bashkëlidhur dokumentin bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

2. Për shqyrtimin e ankesës, operatori ekonomik ankimues detyrohet të paguajë pranë Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohe;

b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohe;

c) Kur ankesa paraqitet për pavlefshmërinë e kontratës, 0.5% të vlerës së kontratës së nënshkruar.

3. Parapagimi i tarifës nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar është kusht i domosdoshëm për pranimin dhe shqyrtimin e ankesës. Në rastet e moskryerjes së pagesës, autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik i lind e drejta e mospranimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar.

Në çdo rast, pagesa e tarifës i kthehet operatorit ekonomik ankimues ose operatorit ekonomik të interesuar, i cili ka kundërshtuar vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, nëse ankesa e tyre është pranuar plotësisht ose pjesërisht nga Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Në rastin kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimit derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

5. Vendimi nr. 261, datë 17.3.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku